

**MARREVESHJE BASHKIMI ME PERTHITHJE**  
**MIDIS SHOQERIVE TRIMED SH.P.K (SHOQERIA PERTHITHESE) DHE**  
**RIOFARMA SH.P.K. (SHOQERIA E PERTHITHUR)**

Kjo Marreveshje Bashkimi me perthithje (“**Marreveshja**”) lidhet me date **30/06/2024**, ne Tirane, ndermjet:

**Trimed Sh.p.k.**, nje shoqeri e organizuar dhe qe ekziston sipas ligjeve te Republikes se Shqiperise, e regjistruar me Regjistrin Tregtar me numer biznesi K51612031J, dhe me seli ne adresen Autostrada "Tirane -Durres", Km 10, Zone Kadastrale 2105, Nr. Pasurie 95/11, perfaqesuar nga administratorja Znj. Gentiana Peshkatari (“**Trimed**”)

dhe

**Riofarma Sh.p.k.** nje shoqeri e organizuar dhe qe ekziston sipas ligjeve te Republikes se Shqiperise, e regjistruar me Regjistrin Tregtar me numer biznesi J61817032C, dhe me seli ne adresen Katund i Ri, Autostrada Tirane-Durres, Rruga Dytesore, Km 9, perfaqesuar nga administratorja Remila Abazi (“**Riofarma**”)

Secili quajtur “**Pala**” dhe bashkerisht “**Palet**”

**MEQENESE:**

- Ne date 20.05.2024, Asamblete e ortakeve te shoqerise Trimed Sh.p.k (shoqeria perthithese) dhe shoqerise Riofarma Sh.p.k (shoqeria e perthithur) vendosen miratimin e fazes se pare, pra miratimin ne parim te fillimit te procedures se bashkimit me perthithje te shoqerise Riofarma Sh.p.k, shoqeria e perthithur, me shoqerine Trimed Sh.p.k, shoqeria perthithese. (“Faza I-re”).
- Shoqeria Riofarma Sh.p.k, shoqeria qe do te perthithet zoterohet 100% nga Trimed Sh.p.k, shoqeria perthithese.
- Sipas nenit 225 te ligjit “Per Tregtaret dhe Shoqerite tregtare” ne kushtet e perthithjes te shoqerise bje nga shoqeria meme, disa prej raporteve te parashikuara ne ligjin “Per shoqerite tregtare” nuk jane te detyrueshme per t’u pergatitur.
- Po ashtu, asamblete e ortakeve te shoqerise Trimed Sh.p.k (shoqeria perthithese) dhe shoqerise Riofarma Sh.p.k (shoqeria e perthithur), perjashtuan administratoret dhe ekspertet nga detyrimi i pergatitjes se disa nga dokumentet dhe raportet, sipas ligjit 9901/2008 “Per shoqerite tregtare”.
- Depozitimi ne QKB i Fazes se pare eshte perfunduar ne date 23.05.2024 per shoqerine Riofarma Sh.p.k (Shoqeria e perthithur) dhe ne date 30.05.2024 per shoqerine Trimed Sh.p.k (shoqeria perthithese)
- Po ashtu, shoqeria Trimed Sh.p.k (shoqeria perthithese) ka paraqitur ne faqen e saj te internetit aktet e Fazes se pare ne daten 22.05.2024.

**SA ME SIPER**, Palet bien dakord dhe pranojne te lidhin kete Marreveshje te bashkimit me perthithje sipas kushteve dhe afateve te meposhtme.

### **Neni 1 – Parashtrimet**

Parashtrimet dhe Shtojcat jane pjese thelbesore dhe perberese e kesaj Marreveshje.

### **Neni 2 – Bashkimi me perthithje**

2.1 Ne perputhje me kushtet dhe afatet e percaktuara ne kete Marreveshje, Palet bien dakord qe te miratojne dhe caktojne rregullat e bashkimit me perthithje te shoqerive te meposhtme:

- **Riofarma Sh.p.k.**, shoqeri me pergjegjesi te kufizuar, me seli ne adresen: Katund i Ri,  
Autostrada Tirane-Durres, Rruga Dytesore, Km 9 (shoqeria qe do te perthithet)
- **Trimed Sh.p.k.**, shoqeri me pergjegjesi te kufizuar, me seli ne adresen Autostrada "Tirane -Durres", Km 10, Zone Kadastrale 2105, Nr. Pasurie 95/11, (shoqeria perthithese)

si dhe te transferimit te te gjitha aktiveve dhe pasiveve te shoqerise Riofarma Sh.p.k (shoqeria qe do te perthithet) tek shoqeria **Trimed Sh.p.k** ("Transaksioni") shoqeria perthithese, bashkim i cili do te jete objekt i miratimit te asambleve te ortakeve te shoqerise perthithese dhe te shoqerise se perthithur.

**Data e bashkimit me perthithje do te jete data 31.12.2023**, duke u bazuar ne **Pasqyrat Financiare te mbyllura me 31.12.2023** te shoqerise **Trimed Sh.p.k** (shoqeria perthithese) dhe te shoqerise **Riofarma Sh.p.k** (shoqeria qe do te perthithet), date ne cilen do te kryhen te gjitha operacionet dhe veprimet kontabel te procesit te bashkimit me perthithje. Shoqeria **Trimed Sh.p.k** e cila eshte shoqeria perthithese e shoqerise Riofarma Sh.p.k, ka kryer te gjitha rregullimet kontabel te konsolidimit duke ju referuar pasqyrave financiare te mbyllura per secilen shoqeri me date 31.12.2023 (Data e fundit Kontabel), ne perputhje me parimet dhe standartet kontabel .

2.2 Qellimi i Transaksionit eshte zvogelimi i kostove dhe bashkimi i sinergjive meqenese shoqeria qe do te perthithet zoterohet 100% nga shoqeria perthithese.

2.3 Te gjitha veprimet dhe rregjistrimet kontabel te kryera nga shoqeria **Riofarma Sh.p.k** (shoqeria qe do te perthithet) **qe i perkasin periudhes 01.01.2024 deri ne daten e perfundimit te procesit te bashkimit me perthithje ne QKB**, do te trajtohen dhe regjistroheshen nga pikepamja kontabel si veprime te shoqerise **Trimed shpk** e cila eshte shoqeria perthithese.

2.4 **Trimed Sh.p.k eshte shoqeri meme**, zoteruese e 100% te kapitalit te shoqerise **Riofarma Sh.p.k** Per pasoje, **Trimed Sh.p.k** ne cilesine e ortakut, ka te njejta te drejta sic i ka aktualisht kundrejt **Riofarma Sh.p.k.**

2.5 Palet bien dakord qe te mos u japin perparesi te vecanta administratoreve, apo Audituesve ligjore. Administratori i **Riofarma Sh.p.k** do te largohet me miratimin e Transaksionit nga asamblete perkatese te shoqerive pale ne Transaksion.

2.6 **Riofarma Sh.p.k** është aktualisht një shoqëri pa aktivitete dhe për pasojë pa punëmarres dhe Transaksioni nuk do të ketë asnjë ndikim në strukturën e punëmarresve.

2.7 Bashkimi me përthithje nuk do të ketë efekte të tjera lidhur me kapitalin e Shoqërisë Përthithëse duke qënë se shoqëria Trimed Sh.p.k zotëron 100% të kuotave në shoqërinë e përthithur **Riofarma Sh.p.k**. Për këtë arsye, nuk është i nevojshëm raporti i këmbimit të kuotave/aksioneve. **Kapitali i shoqërisë Trimed Sh.p.k nuk do të zmadhohet nga Transaksioni.**

2.8 Pas nënshkrimit të kësaj Marreveshje të bashkimit me përthithje, Palet do të depozitojnë këto Marreveshje dhe dokumentet përkatëse në Regjistrin Tregtar pranë QKB. Miratimi i Transaksionit dhe përmbyllja e tij nënkupton:

- nënshkrimin e marreveshjes së bashkimit me përthithje
- miratimin e marreveshjes së bashkimit me përthithje dhe të Transaksionit nga asamblëe të ortakeve të Paleve
- deklaratën e largimit/dorëheqjes së administratorit të shoqërisë Riofarma Sh.p.k
- statutin e ri të shoqërisë Trimed Sh.p.k, nëse është e nevojshme.

2.9 Në përfundim të procesit të bashkimit me përthithje dhe me realizimin e Transaksionit, **Riofarma Sh.p.k** do të konsiderohet e prishur pa likuidim duke kaluar dhe transferuar tek shoqëria Trimed Sh.p.k të gjitha aktivitetet dhe pasivitetet e saj në gjendjen në datën e përcaktuar në nenin 2.3 më sipër, duke u regjistruar nga Regjistri Tregtar pa kaluar në likuidim.

2.10 Meqenëse **Trimed Sh.p.k** është përfituese e vetme tëshme e kontrollit të shoqërisë Riofarma Sh.p.k dhe ky përfitim kontrolli është miratuar nga Autoriteti i Konkurrencës, bashkimi me përthithje dhe Transaksioni nuk sjellin një ndryshim kontrolli dhe as detyrimin për miratimin e Transaksionit nga Autoriteti i Konkurrencës.

### **Neni 3 – Bilancet Individuale në Mbyllje dhe Bilanci në Celje i Bashkimit me Përthithje**

3.1 Procedura e Bashkimit me Përthithje të shoqërisë **Riofarma Sh.p.k** (shoqëria e përthithur), një shoqëri e organizuar dhe që ekziston sipas ligjeve të Republikës së Shqipërisë, e regjistruar me Regjistrin Tregtar me numër biznesi J61817032C, **me Shoqërinë Trimed Sh.p.k (Shoqëria përthithëse)**, një shoqëri e organizuar dhe që ekziston sipas ligjeve të Republikës së Shqipërisë, e regjistruar me Regjistrin Tregtar me numër biznesi K51612031J, është realizuar duke ju referuar **Pasqyrave Financiare individuale të secilës prej shoqërive të datës 31.12.2023 (Data e fundit kontabel)**, të cilat përfaqësojnë Bilancet Individuale të shoqërive përkatëse, në përputhje me pikën 5, Neni 216, i Ligjit nr.9901, datë 14.4.2008 “Për Tregtarët dhe shoqëritë Tregtare”, i ndryshuar.

### **3.2 TRIMED Sh.p.k**

Pasqyrat Financiare të shoqërisë Trimed Sh.p.k për vitin tatimor 2023, të paraqitura në vijim, janë për gatitur në përputhje me Standardet Nderkombetare të Raportimit Financiar (SNRF), të publikuara nga Bordi i Standardeve Nderkombetare të Kontabilitetit (BSNK).

## Pasqyra e Pozicionit Financiar me 31.12.2023

### **TRIMED SHPK**

( Te gjitha shumat jane te shprehur ne leke pervec rasteve te shprehura ndryshe)

#### **Pasqyra e pozicionit financiar me 31 Dhjetor 2023**

		<b>31 Dhjetor 2023</b>
<b>AKTIVE</b>	<b>Shënime</b>	
<b>Aktive aftashkurtra</b>		
Mjete monetare dhe të ngjashme	1	136,297,557
Të drejta të arkëtueshme, neto (kliente)	2	416,507,854
Te arketueshme te tjera (dividend nga pjesmarrjet )	3	-
Parapagime	4	1,264,929
Te drejta te tjera per tu arketuar	5	13,098,349
Inventari ( Mallra dhe inventari i imet)	6	1,339,538,364
Aktive te shtyra ( shpenzime te periudhave ardhshme)	7	46,904,217
<b>Total - Aktive afatshkurtra</b>		<b>1,953,611,269</b>
<b>Aktive afatgjata</b>		
Investime ne pjesemarrje	8	82,244,214
Aktive afatgjata materiale	9	117,140,557
<b>Total - Aktive aftagjata</b>		<b>199,384,772</b>
<b>TOTAL AKTIVE</b>		<b>2,152,996,040</b>
<b>Detyrime afatshkurtra</b>		
Huatë nga institucionet financiare	10	6,000,000
Arketime ne avance per porosi	11	-
Furnitorë dhe të tjera detyrime	12	926,358,053
Detyrime ndaj ortakeve	13	377,535,528
Detyrime Personeli dhe sigurime shoqerore	14	16,455,733
Te tjera te pagueshme detyrime tatimore	15	10,119,895
Detyrime te tjera	16	10,866,674
<b>Total - Detyrime afatshkurtra</b>		<b>1,347,335,884</b>
<b>Detyrime afatgjata</b>		
Huatë nga institucionet financiare		-
Detyrime te treteve (Financime ortak)	17	436,688,373
<b>Total - Detyrime afatgjata</b>		<b>436,688,373</b>
<b>KAPITALI DHE DETYRIMET</b>		
Kapitali aksionar	18	60,900,000
Rezerva ligjore		6,090,000
Fitim i pashpërndarë		37,832,933
Fitim i vitit		264,148,851
<b>Total – Kapitali</b>		<b>368,971,784</b>
<b>Total - Detyrime afatgjata dhe kapitali</b>		<b>805,660,157</b>
<b>TOTAL KAPITALI DHE DETYRIMET</b>		<b>2,152,996,040</b>

### **3.3 RIOFARMA Sh.p.k**

Pasqyrat e Pozicionit Financiar e shoqerise Riofarma Sh.p.k, per vitin tatimor 2023, paraqitet si me poshte:

#### **Pasqyra e Pozicionit Financiar me 31.12.2023**

##### **RIOFARMA Sh.p.k**

*( Te gjitha shumat jane te shprehur ne leke pervec rasteve te shprehura ndryshe)*

##### **Pasqyra e pozicionit financiar me 31 Dhjetor 2023**

		<b>31 Dhjetor 2023</b>
<b>AKTIVE</b>	<b>Shënime</b>	
<b>Aktive aftashkurtra</b>		
Mjete monetare dhe të ngjashme	1	-
Të drejta të arkëtueshme, neto (kliente)	2	104,468,828
Te arketueshme te tjera (dividend nga pjesmarrjet )	3	-
Parapagime	4	-
Te drejta te tjera per tu arketuar	5	5,466,300
Inventari ( Mallra dhe inventari i imet)	6	-
Aktive te shtyra ( shpenzime te periudhave ardhshme)	7	-
<b>Total - Aktive afatshkurtra</b>		<b>109,935,128</b>
<b>Aktive afatgjata</b>		
Investime ne pjesemarrje	8	-
Aktive afatgjata materiale	9	55,193
<b>Total - Aktive aftagjata</b>		<b>55,193</b>
<b>TOTAL AKTIVE</b>		<b>109,990,321</b>
<b>Detyrime afatshkurtra</b>		
Huatë nga institucionet financiare	10	-
Arketime ne avance per porosi	11	-
Furnitorë dhe të tjera detyrime	12	37,186,700
Detyrime ndaj ortakeve	13	-
Detyrime Personeli dhe sigurime shoqerore	14	-
Te tjera te pagueshme detyrime tatimore	15	1,360
Detyrime te tjera	16	-
<b>Total - Detyrime afatshkurtra</b>		<b>37,188,060</b>
<b>Detyrime afatgjata</b>		
Huatë nga institucionet financiare		-
Detyrime te tjera	17	34,454,473
<b>Total - Detyrime afatgjata</b>		<b>34,454,473</b>
<b>KAPITALI DHE DETYRIMET</b>		
Kapitali aksionar	18	40,273,796
Rezerva ligjore		-
Fitim i pashpërndarë	-	1,712,998
Fitim i vitit	-	213,010
<b>Total – Kapitali</b>		<b>38,347,788</b>
<b>Total - Detyrime afatgjata dhe kapitali</b>		<b>72,802,261</b>
<b>TOTAL KAPITALI DHE DETYRIMET</b>		<b>109,990,321</b>

### 3.4 Bilanci i Celjes se Bashkimit me Perthithje

**Pasqyrat e Pozicionit Financiar e Konsoliduar** e shoqerise Trimed Sh.p.k pas **Bashkimit me Perthithje**, eshte pergatitur bazuar ne Pasqyrat Financiare individuale te shoqerise **Riofarma Sh.p.k** (Shoqeria e perthithur) dhe **Trimed Sh.p.k** (Shoqeria perthithese), te dates 31.12.2023 (**Data e fundit Kontabel**), ne perputhje me parimet dhe Standardet Kontabel.

### Pasqyra e Konsoliduar e Pozicionit Financiar

#### Trimed Sh.p.k, Pas Bashkimit me Perthithje

Date 31.12.2023

**Pasqyra e Konsoliduar e Pozicionit Financiar Trimed Sh.p.k (Pas Bashkimit me Perthithje)**

(Te gjitha shumat jane te shprehur ne leke pervec rasteve te shprehura ndryshe)

**Pasqyra e pozicionit financiar me 31 Dhjetor 2023**

		Trimed Sh.p.k	Riofarma Sh.p.k	Rregullime	Trimed Sh.p.k pas Bashkimit
		31 Dhjetor 2023	31 Dhjetor 2023	Konsolidimi	31 Dhjetor 2023
<b>AKTIVE</b>	<b>Shënime</b>				
<b>Aktive aftashkurtra</b>					
Mjete monetare dhe të ngjashme	1	136,297,557	-	-	136,297,557
Të drejta të arkëtueshme, neto (kliente)	2	416,507,854	104,468,828	(128,098,826)	392,877,856
Te arketueshme te tjera (dividend nga pjesmarrjet)	3	-	-	-	-
Parapagime	4	1,264,929	-	-	1,264,929
Te drejta te tjera per tu arketuar	5	13,098,349	5,466,300	(5,466,300)	13,098,349
Inventari ( Mallra dhe inventari i imet)	6	1,339,538,364	-	-	1,339,538,364
Aktive te shtyra ( shpenzime te periudhave ardhshme)	7	46,904,217	-	-	46,904,217
<b>Total - Aktive afatshkurtra</b>		<b>1,953,611,269</b>	<b>109,935,128</b>		<b>1,929,981,271</b>
<b>Aktive afatgjata</b>					
Investime ne pjesemarrje	8	82,244,214	-	(40,273,796)	41,970,418
Aktive afatgjata materiale	9	117,140,557	55,193	-	117,195,750
<b>Total - Aktive aftagjata</b>		<b>199,384,772</b>	<b>55,193</b>		<b>159,166,169</b>
<b>TOTAL AKTIVE</b>		<b>2,152,996,040</b>	<b>109,990,321</b>	<b>(173,838,922)</b>	<b>2,089,147,439</b>
<b>Detyrime afatshkurtra</b>					
Huatë nga institucionet financiare	10	6,000,000	-	-	6,000,000
Arketime ne avance per porosi	11	-	-	-	-
Furnitorë dhe të tjera detyrime	12	926,358,053	37,186,700	(122,160,676)	841,384,077
Detyrime ndaj ortakëve	13	377,535,528	-	-	377,535,528
Detyrime Personeli dhe sigurime shoqerore	14	16,455,733	-	-	16,455,733
Te tjera te pagueshme detyrime tatimore	15	10,119,895	1,360	-	10,121,255
Detyrime te tjera	16	10,866,674	-	-	10,866,674
<b>Total - Detyrime afatshkurtra</b>		<b>1,347,335,884</b>	<b>37,188,060</b>		<b>1,262,363,268</b>
<b>Detyrime afatgjata</b>					
Detyrime te tjera		-	34,454,473	(11,404,450)	23,050,023
Detyrime te treteve (Financime ortak)	17	436,688,373	-	-	436,688,373
<b>Total - Detyrime afatgjata</b>		<b>436,688,373</b>	<b>34,454,473</b>		<b>459,738,396</b>
<b>KAPITALI DHE DETYRIMET</b>					
Kapitali aksionar	18	60,900,000	40,273,796	(40,273,796)	60,900,000
Rezerva ligjore		6,090,000	-	-	6,090,000
Fitim i pashpërndarë		37,832,933	1,712,998	-	36,119,935
Fitim i vitit		264,148,851	213,010	-	263,935,841
<b>Total – Kapitali</b>		<b>368,971,784</b>	<b>38,347,788</b>		<b>367,045,776</b>
<b>Total - Detyrime afatgjata dhe kapitali</b>		<b>805,660,157</b>	<b>72,802,261</b>		<b>826,784,172</b>
<b>TOTAL KAPITALI DHE DETYRIMET</b>		<b>2,152,996,040</b>	<b>109,990,321</b>	<b>(173,838,922)</b>	<b>2,089,147,439</b>

#### Neni 4 – Te ndryshme

4.1 Kjo Marreveshje rregullohet nga legjislacioni shqiptar. Per sa nuk parashikohet ne kete Marreveshje, zbatohen ne veçanti dispozitat e Kodit Civil te Republikes se Shqiperise.

4.2 Mosmarreveshjet qe mund te lindin ndermjet Paleve nga kjo, apo ne lidhje me kete Marreveshje do te zgjidhen me mirekuptim midis tyre. Ne rast te kundert, kompetente per zgjidhjen e tyre do te jete Gjykata e Rrethit Gjyqesor Tirane.

4.3 Kjo Marreveshje mund te ndryshohet vetem permes nje marreveshjeje me shkrim te nenshkuar nga Palet.



Kjo Marreveshje eshte hartuar ne 2 (dy) kopje origjinale ne gjuhen shqipe, te gjitha te nenshkuara nga Palet dhe me vlere te njejte ligjore dhe hyn ne fuqi qe nga momenti i nenshkrimit te saj.

Nenshkuar nga Palet:

**RIOFARMA SH.P.K.**

  
  
RIO - FARMA ALBANIA  
TEL +355 4 221 958  
FAX +355 4 222 265

**TRIMED SH.P.K.**

  
  
TRIMED  
Sh.p.k.  
Nipt: K51612031J  
5  
KOMPANI FARMACEUTIKE  
TIRANE - ALBANIA

## ANEKS 2

### MARREVESHJE BASHKIMI ME PERTHITHJE MIDIS SHOQERIVE TRIMED SH.P.K (SHOQERIA PERTHITHESE) DHE RIOFARMA SH.P.K. (SHOQERIA E PERTHITHUR)

(Per destinacionin e vleres se kapitalit te shoqerise Riofarma pas bashkimit me perthithje)

Në vijim të sa përcaktuar në pikën 2.7, të Nenit 2 të Marrëveshjes së Bashkimit me Përthithje të lidhur midis palëve, e cila citon:

Bashkimi me perthithje nuk do të ketë efekte të tjera lidhur me kapitalin e Shoqërisë Përthithëse duke qënë se shoqëria Trimed Sh.p.k zotëron 100% të kuotave në shoqërinë e përthithur **Riofarma Sh.p.k.** Për këtë arsye, nuk është i nevojshëm raporti i këmbimit të kuotave/aksioneve. **Kapitali i shoqerise Trimed Sh.p.k nuk do te zmadhohet nga Transaksioni.**

Shoqëritë pjesëmarrëse në këtë Bashkim me Përthithje, referuar në këtë Aneks Marrëveshje si Palët, shprehen si më poshtë:

- **Trimed Sh.p.k** është shoqëria mëmë, zotëruese e 100% të kapitalit të shoqërisë **Riofarma Sh.p.k.** Për pasoje, **Trimed Sh.p.k** në Pasqyrat Financiare Para Bashkimit me Përthithje të hartuara dhe dorëzuara për vitin tatimor 2023, në Aktiv të Pasqyrës së Pozicionit Financiar ka zërin **“Investime në Pjesëmarrje”** në shumën **82,244,214 lekë**, ku shuma **40,273,796 lekë** përfaqëson **Vlerën e Kuotës** që shoqëria **Trimed Sh.p.k** zotëron në shoqërinë **Riofarma Sh.p.k.**, vlerë kjo e barabartë me shumën e **Kapitalit aksionar** të shoqërisë **Riofarma Sh.p.k.**, si paraqitur në Pasqyrën e Pozicionit Financiar të kësaj fundit.
- Si rrjedhojë e sa më sipër, palët shprehen se Bashkimi me Përthithje nuk ka asnjë efekt në zmadhimin e kapitalit të shoqërisë përthithëse duke qënë se në Pasqyrat Financiare të Konsoliduara të shoqërisë **Trimed Sh.p.k.**, të hartuara **Pas Bashkimit me Përthithje**, shuma **40,273,796 lekë** e **Kapitalit aksionar të shoqërisë së përthithur Riofarma Sh.p.k.**, do të reduktojë shumën e **“Investimit në Pjesëmarrje”** të shoqërisë **Trimed Sh.p.k** me po të njëjtën vlerë **40,273,796 lekë**, në zbatim të sa përcaktuar nga *Standardet Ndërkombëtarë të Raportimit Financiar* si dhe *Ligjit për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare*.

Zeri	Para bashkimit		Efektet e konsolidimit	Pas bashkimit	
	T R I M E D Sh.p.k	RIOFARMA Sh.p.k		T R I M E D Sh.p.k	RIOFARMA Sh.p.k
Investime ne pjesemarrje (aktiv)	82,244,214 lekë		-40,273,796	41,970,418	
Kapitali Aksionar (Pasiv)		40,273,214	-40,273,796		0



Ky Aneks Marrëveshje rregullohet nga legjislacioni shqiptar. Për sa nuk parashikohet në këtë Aneks Marrëveshje, zbatohen në veçanti dispozitat e Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë.

Ky Aneks Marrëveshje mund të ndryshohet vetëm përmes një marrëveshjeje me shkrim të nënshkruar nga Palët.

Ky Aneks Marrëveshje është hartuar në 2 (dy) kopje origjinale në gjuhën shqipe, të gjitha të nënshkruara nga Palët dhe me vlerë të njëjtë ligjore dhe hyn në fuqi që nga momenti i nënshkrimit të tij.

Nënshkruar nga Palët:

**RIOFARMA SH.P.K.**

*Renata Haxhi*  
  


**TRIMED SH.P.K.**

*Shpresa Reshketari*  
  


**ANEKS NR 1**

Me date 30.06.2024, Asambleja e Ortakeve te shoqerise Trimed Shpk, eshte mbledhur per te diskutuar miratimin e bashkimit me perthithje te shoqerise Riofarma Shpk. (shoqeri bije) nga ana e shoqerise Trimed Shpk. (shoqeri meme). Ne kete asamble, ortaket e shoqerise Trimed Shpk., kane vendosur te miratojne:

- (i) bashkimin me perthithje te Riofarma Shpk. nga ana e Trimed Shpk.
- (ii) marreveshjen e bashkimit

Sipas Marreveshjes se Bashkimit

**A. Trimed Sh.p.k eshte shoqeri meme, zoteruese e 100% te kapitalit te shoqerise Riofarma Sh.p.k** Per pasoje, Trimed Sh.p.k ne cilesine e ortakut, ka te njejta te drejta sic i ka aktualisht kundrejt **Riofarma Sh.p.k. (neni 2.4)**

**B. Bashkimi me perthithje nuk do të ketë efekte të tjera lidhur me kapitalin e Shoqërisë Përthithëse duke qënë se shoqeria Trimed Sh.p.k. zotëron 100% të kuotave në shoqërinë e përthithur Riofarma Sh.p.k. Për këtë arsye, nuk është i nevojshëm raporti i këmbimit të kuotave/aksioneve. Kapitali i shoqerise Trimed Sh.p.k. nuk do te zmadhohet nga Transaksioni. (neni 2.7)**

C. Tabela e kapitalit (Ref. Marreveshja e bashkimit – Neni 3.2)

Zeri i kapitalit	Para bashkimit		Pas bashkimit	
	Trimed Sh.p.k	Riofarma Sh.p.k	Trimed Sh.p.k	Riofarma Sh.p.k
<b>Kapitali aksionar</b>	<b>60,900,000</b>	<b>40,273,796</b>	<b>60,900,000</b>	<b>0</b>

